



PROCESVERBAL IV/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së IV (katërt) për vitin 2023 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 19.04.2023
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

z. Urim Suka

znj. Bulëza Kuçi

znj. Sanie Kuçi Rexhepaj

znj. Fidaije Kukaj

z. Dardan Berisha

z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore

Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim

Përfaqësues i OSBE-së

Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-56,të datës15.03.2007;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2022 të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. ;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Ekonomike” në Duhël;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Industriale” në Shirokë;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-14453;
7. Shqyrtimi i petitionit;
8. Raporti i ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar-mars 2023 të Komunës së Suharekës;

Sanie Kuçi Rexhepaj - është e pesta mbledhje që unë po e pres një pikë të rendit të ditës e cila është raportimi e PZHK-së. Në dhjetor ka qenë obligative dhe me plan të Kuvendit të punës. Në janar e ngrita si çështje në Asamble që me i dhënë afat ekzekutivit me hartuar atë raport deri në mars. Këtë mbledhje po i votoj pikat e rendit të ditës por nëse mbledhjen tjetër nuk sillet raportimi i PZHK-së ,unë nuk do ta votoj asnjë pikë të rendit të ditës. Nuk është kushtëzim por nëse ekzekutivi tregon papërgjegjshmëri në këtë rast,atëherë as unë s’kam nevojë ti votoj pikat e rendit të ditës.

Kryesuesi - pajtohem me ty. Faktikisht është diskutuar edhe në Asamble. Drejtori është zotu që do ta sjell në mars por nuk e ka sjellë. Shqetësimin tënd do ta përcjell te Kryetari dhe te Drejtori i Urbanizmit.

Urim Suka - te pika shqyrtimi i petitionit,kërkoj që për Asamble të jetë si pikë e parë e rendit të ditës.

Kryesuesi - ne e kemi fut si pikë dhe kur të vijmë te pika e shtatë e diskutojmë si pikë.

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Sanie Kuçi Rexhepaj - te disa pjesë mos të thuhet x personi jep sqarime por të shënohet në procesverbal çfarë sqarime ka dhënë.

Kryesuesi - e hedhë në votim me vërejtjen që u tha.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-56,të datës 15.03.2007;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Dardan Berisha - kërkoj sqarime më shumë për burimin e ujit mineral në fshatin Reqan .Trungjet që janë dëmtuar,a kanë me u zëvendësua dhe ku gjendet trugu i Dushkut në Suharekë?

Kryesuesi - trugu i Dushkut gjendet te rrafshi Osoja.

Avni Bytyqi - në bazë të ligjit për mbrojtjen e natyrës, Komuna e ka për obligim ti monitorojë elementet që kanë mbrojtje natyrore. Është konstatuar që në 2018,që tri trungjet e cekura në këtë projekt-vendim janë dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore dhe nga dora e njeriut. Është dëmtuar uji i thartë në Reqan si dhe një trung afër ujit dhe në Greikoc, ku sipas raportit të 2018 dhe të 2021-tës është kërkuar që të hiqen nga vendimi për mbrojtjen e vlerave natyrore. Ndërsa kanë konstatua që duhet të futen në mbrojtjen e vlerave

natyrore trangu i dushkut në Suharekë, trangu i dushkut në Krushicë të Poshtme, te varrezat dhe trangu i dushkut në Bllacë, në varreza. Zyrtari ligjor tuje jep sqarime.

Urim Suka - shqetësimet i pata të njëjtat sikur të Dardanit por më shqetëson dhe fakti pasi ato zona janë të mbrojtura dhe janë dëmtu nga dora e njeriut dhe nga natyra. A ka një raport? A është dënu dikush? Pse janë mbrojtë këto dhe a i ruan dikush këto?

Avni Bytyqi - sipas raportit plepi po shihet që është pre ndërsa ujit mineral i ka humb vetvetiu vlera.

Dardan Berisha - a ka mundësi që këto trungje që janë të ruajtura prej institucionit me i rrethu dhe me vendos një tabelë që ato trungje janë në mbrojtje të atij departamenti.

Bulëza Kuçi - këto ishin edhe mendimet e mia, por a ka mundësi ta analizoj situatën një ekipi special më mirë, që ta dimë ne a ka mundësi me u renovu ose me u rigjeneru. P.sh. te uji.

Avni Bytyqi - uji vetvetiu e ka humb vlerën.

Sanie Kuçi Rexhepaj - A është puna e Kuvendit apo e Ministrisë në bazë të ligjit me marrë këtë vendim? Nëse është e Kuvendit, a ka mundësi që për këto trungje me u caktu koordinatat njëjtë si ka qenë dhe 2007-tën sepse unë në këtë rast nuk po e di se ku gjenden këto trungje.

Avni Bytyqi - takimin që kam pas me ta, kam kërkuar që ti sjellin koordinatat. Sipas tyre nuk është e nevojshme që të futen tash koordinatat në kuadër të projekt-vendimit, për arsye se ligji ka ndryshuar. Me ligjin e 2010-tës e kanë bartë si kompetencë që Komuna me i monitoru dhe aty ku e sheh që duhet të futet në kuadër të mbrojtjes të vlerave të natyrës, me vendim të Kuvendit të futen në mbrojtje të vlerave të natyrës. Mua m'i kanë dërgu koordinatat mirëpo ata kanë kërku që me përcaktua edhe sipërfaqen.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ku ta dimë ne se ku është ai trung?

Avni Bytyqi - sipas drejtorit të Urbanizmit janë të parapara në HZK dhe PZHK.

Kryesuesi - atëherë për secilën pikë i japim koordinatat.

Liridon Fandaj - këto monumente a janë pronësi komunale apo private? P.sh. te uji mineral, në publik e kam dëgjua që parashihet të bëhet fabrikë e ujit mineral. Mos është shkak kjo që me e heq ne atë pjesë të ujit dhe me u bë fabrikë aty.

Kryesuesi - është pronë publike. Në të kaluarën ka dal uji në sipërfaqe mirëpo tash nuk ka ujë dhe për atë ata kanë kërkuar që të hiqet.

Urim Suka - ne po i ngrisim shqetësimet që me i pas parasysh edhe ju dhe ky material mendoj që duhet me shku në Asamble dhe kur të merret vendimi me mujt me u implementu.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2022 të komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - kur është formu atëherë komisioni, është bërë me njerëzit tuaj, njëanshëm dhe pak a shumë rezultati i punës është shqetësues duke u lidh edhe me raportin. Në raport shkruan: në mungesë të korumit të bordit të drejtorëve kemi marrë kërkesë për vazhdimin e mandatit të kryeshefit ekzekutiv deri në plotësimin e bordit. Këtu shkruan që është shpall një konkurs për dy pozita. Ju e dini se çka ka ndodh me atë konkurs, sa hetimet janë duke u bërë. Kjo është shqetësuese dhe uroj ti gjindet një zgjidhje asaj situate që e keni kriju atje dhe të funksionojë më mirë ndërmarrja. Ju nuk po i dëgjoni vërejtjet tona dhe e keni prur ndërmarrjen deri këtu. U desh të jetë dikush këtu që të raportojë, që ne ta dimë gjendjen pak më mirë.

Kryesuesi - e vetmja ndërmarrje publike që menaxhohet nga Kuvendi është stacioni i autobusëve. Ka ndodh kjo por ne jemi duke prit përgjigje nga institucioni dhe besoj shumë shpejt do të zgjidhet ky problem sepse është keq situata me menaxhment. Sipas informacioneve ka të hyra pak më mirë se në të kaluarën dhe duhet të bëhet një zgjidhje në mënyrë që të kompletohet stafi sa më shpejt.

Liridon Fandaj - ashtu si thotë dhe Urimi, nuk e kemi një përgjigje prezente për ta raportuar këtë raport financiar. Kanë avancu në pasqyra financiare por është dallim shumë i vogël në të hyra sepse vitin e kaluar ka pas humbje. Unë zyrtarisht i kam kërkuar kontratat dhe është qesharake që ne në teren i shohim lokalet që funksionojnë dhe janë shumë pak kontrata që mi kanë ofruar. Duhet me dal në teren sepse ajo menaxhohet prej Komunës dhe duhet ta dimë ato lokale kush i shfrytëzon.

Dardan Berisha - sa i përket raportit asnjëherë nuk ka ardhë më i përgatitur. Komisioni është formu në mënyrë shumë demokratike. Sa i përket problemeve të konkursit, ne e dimë por ndoshta nuk i ka gjithë fajet komisioni se pse bordit i ka kalu mandati. Shpresoj që së shpejti të zgjidhet ky problem sepse në korrik mundet me pas edhe probleme tjera.

Kryesuesi - njëri anëtar i bordit ka pas mandat por ka dhënë dorëheqje.

Urim Suka - në raport shkruan që po punohet me humbje sepse autobusët nuk hyn në stacion. Kjo është e thjeshtë. Nëse tarifa e autobusit është e madhe ,ulenë tarifën,nëse s'është e madhe, janë inspektorat të cilët duhet të dalin në teren dhe ti dënojnë.

Dardan Berisha - këto probleme nuk janë të 2023-tës por janë probleme prej 2000-tës.Ju e dini që është pronë e pylltarisë. P.sh. një kompani turistike ka të drejtë ligjore mos me dhënë asnjë cent sepse duhet me ja dhënë pylltarisë. Raporti është shumë më i detajuar se që ka qenë.

Kryesuesi - të hyrat i ka nga inkasimi prej autobusëve. Vijat ndër urbane Prizren-Prishtinë janë 36 nisje. Pra 72 hyrje-dalje vetëm nga kjo i kanë pas. Mirëpo pesë vite e këndeje janë 10 kompani minimum që janë shu. Vijat Suharekë-Prizren,prej 50 nisjeve,kanë rënë në 40. Stacioni i autobusëve licencohet çdo 5 vite.Prej 2015-tës stacioni i autobusëve nuk ka licencë. Kryesuesi tutje jep sqarime.

Urim Suka - në raport nuk shkruan që është zvogëlu numri i vijave por po thuhet që ka probleme sepse autobusët nuk hyjnë aty për tu inkasuar.

Kryesuesi - nuk ka kompetencë të thotë që vijat i kanë shit.

Urim Suka - ka mundur ta cek në raport që për shkak se në vitin 2015 kanë qenë 35 vija dhe tash janë 20 vija, ka më pak inkasim. Por problemi është sepse autobusët nuk po hyjnë, dhe duhet me dal inspektori dhe ju me vepru.

Armend Krasniqi - çështja e stacionit të autobusëve është problematikë ndër vite. Mungesa e licencimit është një ndër shkaqet kryesore. Qelësi i zgjidhjes së stacionit të autobusëve është bartja e tokës pyjore në pronë komunale. Drejtori tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - për deri sa tokat para 50 viteve po bëhen me ndërmjetësim dhe që janë me dokument valid, atëherë përmes ndërmjetësimit mund ta bëjmë shëndrrimin prej pylltarisë këtu dhe ky stacion me marrë një licencë dhe me punu në mënyrë të ligjshme.

Armend Krasniqi - ne po e mbajmë kështu deri sa të bëjmë një zgjidhje më të mirë të mundshme.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

4 për,2 kundër. 1 abstenim

Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Ekonomike” në Duhël;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - ne e kemi dhënë atëherë dhe prapë e japim për të shkuar tutje por nuk e di a e keni ndëgju Selmanin, i cili e ka ngrit këtë çështje dhe fjalë për fjalë me ato vërejtje që ka dhënë Selmani, ministria e ka kthi. Përcille te drejtorët dhe kërko pak seriozitet në vendime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

Unanimisht Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Industriale” në Shirokë;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - ato që thashë për pikën 4,vlejnë edhe për këtë pikë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën5.

Unanimisht Miratohet pika 5.

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vdnimit 01-Nr-016-14453;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - a vje në një seancë tjetër apo çka po ndodhë.

Kryesuesi - ne fillimisht duhet ta shfuqizojmë sepse aty ka shumë prona private dhe nëse merren vesh, atëherë ne do ta sjellim.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

6 për,1 abstenim
Miratohet pika 6.

Pika 7. Shqyrtimi i petitionit;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - Strukturat e LDK-së pas vdekjes së Ibrahim Rugovës e kanë shfrytëzua shumë figurën e Rugovës, Suhareka pak më pak por në këtë pikë është përdorur shumë politikisht. Fillimisht është mundu me fut si pikë jashtë rendit të ditës, duke e shfrytëzua politikisht që nuk kalon vendosja e bustit të Ibrahim Rugovës. Herën e dytë duke e thirrë një seancë të jashtëzakonshme për diçka shumë të zakonshme, ku për deri sa i keni pas 20 nënshkrime dhe keni mund ta sillni si pikë të rregullt të rendit të ditës. Nëse nuk do të kishte kalu si pikë e rregullt, atëherë do të kishte ardhë në shprehje edhe peticioni. U bë pak politikë për me ardhë në këtë pikë. Nëse tash ka ardhë si pikë e rendit të ditës përmes peticionit, kisha pas dëshirë që kjo pikë me qenë e plotësuar edhe me disa informata të tjera për shkak se sheshi i qytetit e ka një projekt zbatues. Në projekt zbatues nuk është e planifikuar në asnjë pikë me u vendos një bust i kujdo çoftë, por një pëlqim paraprakisht nga ana e Urbanizmit do të na ndihmonte neve, që a lejohet apo nuk lejohet në të ardhmen. Nëse afër 6000 nënshkrime të qytetarëve janë pro vendosjes së bustit të Rugovës dhe nëse do të ishte dhe një pëlqim prej Drejtorisë së Urbanizmit, në parim edhe unë jam pro. Por më duket që e keni përdorur shumë politikisht që me ardhë në këtë pikë.

Urim Suka - të them të drejtën, unë çdo herë kur ti e ke marrë fjalën kam pas besim pozitiv. Kur e kemi bërë kërkesën për me fut në rend dite dhe sikur të ishte pranuar kërkesa, asnjë lloj politike nuk do të ishte bërë.

Sanije Kuçi Rexhepaj - cilën pikë jashtë rendit të ditës ju si LDK e keni aprovuar për Asamblë? Asnjë.

Urim Suka - fakti që kjo u bë politike është që propozimin fillestar që ne e kemi pas, ju e keni penguar. Sikur të mos ta pengoni, do të kishte kalu në Asamblë dhe ishte diskutu. Kërkesën për rend dite e bën një asamblesist dhe ne e kemi bërë por nuk ka kalu. 11 nënshkrime i kemi përdorur vetëm për seancë të jashtëzakonshme sepse nuk e keni kalu për rend dite. Po kërkon procedurë të rregullt, ne tash e kemi sjellë si procedurë të rregullt dhe tash nuk është vetëm kërkesë e LDK-së por edhe e 6000 qytetarëve. Ta kalojmë dhe ta përcjellim për Asamblë.

Bulëza Kuçi - është e habitshme që vje puna me diskutu për këtë çështje. Unë veq dyshova në fjalët e tua kur the kalon ose nuk kalon. Pa marrë parasysh nga përkatësitë politike, figura e Ibrahim Rugovës nuk do të duhet ta irritonte askënd. Kjo është turp. Të gjitha partitë politike shkojnë dhe bëjnë homazhe te varri i tij dhe sot vje puna me u diskutu kjo çështje. Është propozim i 6000 njerëzve. Sania përmendi për sheshin se a duhet apo jo por nëse diskutohet kjo, ne ia kemi ndërruar gjithë pamjen e sheshit. Sheshi ka qenë i mbyllur dhe është i devijum total dhe sot po flasim për një bust. Sania tha që po bëni politikë. Nuk ka qenë politike mirëpo ju jeni duke dasht me bërë kundër pa e thënë fjalën kundër. Për mendimin tim është e turpshme por secili e ka ndërgjegjen e vet dhe karakterin e vet.

Sanie Kuçi Rexhepaj - filloi me u marrë komplet kahje tjetër sepse askush nuk e nënvlerësoj figurën e ish Presidentit.

Bulëza Kuçi - mua më duket e turpshme me u diskutu kaq thellë kjo pikë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - unë e hapa si temë dhe thashë që për mendimin tim në disa hapa LDK-ja ka gabu dhe figurën e Ibrahim Rugovës ju e keni shfrytëzua politikisht.

Bulëza Kuçi - në fille ai ka qenë njeriu i LDK-së dhe ne nuk po i japim kahje politike.

Sanie Kuçi Rexhepaj - unë nuk fola për figurën. Tjetra është që, nëse sheshi i qytetit ka pësuar ndryshime, aty janë marrë disa vendime. Vendimet që janë marrë i bartin përgjegjësitë ata persona që kanë marrë vendime për ndryshim të pjesshëm, të përkohshëm apo të përhershëm. Unë kërkoja që nëse kjo pikë shkon tutje, ligjërisht të ndjeket hapat për vendosjen e bustit të ish Presidentit.

Dardan Berisha - nuk ma merr mendja që kemi ardhë me fol për nivele, për karakter. Ju neve po na fryni. Kjo me të vërtetë është kauzë politike. A e keni marrë pëlqimin e lokaleve për vendosjen e bustit? E keni pas pushtetin lokal 12 vite, pse nuk e keni bërë?

Bulëza Kuçi - Dardani po i jep kontekst ashtu si po ka dëshirë. Sa i përket busteve para lokaleve edhe busti i Fadil Vatës është para lokaleve .

Dardan Berisha - ashtu e the.

Urim Suka - kërkesa edhe e qytetarëve është që si Kuvend me marrë këtë vendim. Pjesa tjetër që ka nevojë me ndryshu, ne jemi ata njerëz që mundemi me ndryshu kur ka vullnet politikë. Nuk duam të bëjmë asgjë dhunshëm dhe përtej asaj që është jo ligjore. Ejani si Kuvend,ta japim pëlqimin për këtë pikë,ta kalojmë.Nuk po bëjmë më politikë dhe pjesën që duhet me ndryshu,e ndryshojmë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - pëlqimet e lokaleve nuk mendoj që duhet me u marrë.Unë vetëm kërkoja një pëlqim në parim nga ekzekutivi,në mënyrë që ta dimë dhe ne se ku keni mendu ju, që është pozita më e përshtatshme për vendosjen e bustin.

Urim Suka - Unë po ju them që ta kalojmë dhe nëse ka implikime tjera pastaj ne i ndjekim procedurat tjera.Mos të bëjmë debat politik të panevojshëm,nëse është vullneti me kalu.Nëse nuk është vullneti me kalu,është e drejta juaj.

Sanie Kuçi Rexhepaj - unë e dhashë mendimin tim dhe nëse 6000 qytetarë kanë vlerësu që kjo pikë duhet me u diskutu si pikë e rendit të ditës në Kuvend Komunal.atëherë dhe unë jam në rregull që ta kalojmë në KPF dhe ta diskutojmë në Asamble.

Dardan Berisha - ka plot projekt vendime që kanë ardhë dhe kanë kalu për shkak të nënshkrimeve. Nëse qytetarët kanë bërë kërkesë,ku janë nënshkrimet e qytetarëve ?Unë po e shoh vetëm një kërkesë. Sa i përket busteve dhe sa i përket meritave askush nuk mundet me e mohu. Është në Istog dhe në Prishtinë ,edhe për mua është e mjaftueshme.

Urim Suka - janë dorëzo nënshkrimet.

Bulëza Kuçi - është hera e dytë që në KPF Dardani fjalisë time i jep kontekst tjetër. Unë thashë: le të mbetet në karakterin e gjithë se cilit nëse e voton pro ose kundër.

Kryesuesi - janë duke pritë edhe minimum gjashtë kërkesa tjera me ardhë për vendosjen e busteve. Nëse kalon kjo,a ka sheshi vend edhe për gjashtë tjera?Pasi sheshi nuk ka vend,unë mendoj të mos vazhdojmë me trendin që të vendosim buste.

Urim Suka - Kryesues,kërkesa është për Asamble. Të lus ta përcjellësh për Asamble dhe atje votone si të doni sepse është e drejta juaj.

Liridon Fandaj - nëse e votoni për Asamble,unë do të sjell si pikë shtesë në rend dite në Asamble. Bulëza thotë që mbetet në karakterin e tyre.Ne i mbajmë secili qëndrimet politike.Nëse mua më kanë thënë që s'duhet me përkrah,ai është qëndrim politik por s'do të thotë që unë individualisht nuk e përkrahi.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë:Komiteti për Politikë dhe Financa i rekomandon pikat të cilat i diskuton në KPF për Asamble, me vazhdua apo mos me vazhdu. Pikat e jashtëzakonshme dhe urgjente shkojnë drejtpërdrejtë në seancë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

3 për,2 kundër,3 abstenime
Miratohet pika 7

Pika 8. Raporti i ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar-mars 2023 të Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e hap debatin. Pasi nuk ka debat,Kryesuesi e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Takimi përfundoi:14:45

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj